# 10 Vjetori i Themelimit të Fondit Humanitar "Malësia"
## 10th Anniversary of Humanitarian Fund "Malësia"

2 maj 2004

Fondi Humanitar "MALËSIA" Humanitarian Fund

www.fondihumanitar.org



HUMANIZËM

KULTURË

ARSIM

POLITIKË

Shoqata Atdhetare Shqiptaro-Amerikane
Albanian-American Organization
"Malësia e Madhe"
Detroit•USA

**Shoqata Atdhetare "Malësia e Madhe" nga Detroiti nga zemra i uron Fondit Humanitar "Malësia" përvjetorin e 10 të themelimit; e përgëzon ate për punën dhe sukseset e deritanishme, duke i dëshiruar suksese edhe në të ardhmen.**

**Gjithashtu, ne mbesim të gatshëm për çdo bashkëpunim vëllezeror të mundshëm me interes të përbashkët për kombin dhe vendin tonë.**

*"Ju përgëzoj për punën e deritanishme duke ju dëshiruar suksese në punën tuaj të mëtutejshme.*

*Ndihmat tuaja, e sidomos, ndihmat drejtuar të sëmurëve dhe studentëve meritojnë çdo lavdatë.*

*Urime në dhjetëvjetorin!"*

*PRËNK GJERGJI GJOKAJ*



**E Nderuar Kryesi e Fondit Humanitar "Malësia" Pranoni Urimet më të sinqerta me rastin e 10 vjetorit të themelimit të Organizatës suaj,**

**Anton Ulaj**



Mesazh i Presidentit Lekë Gjolaj ........................6

Falenderim ........................................................7

**Humanizëm** ....................................................9
Rasti i Viktor Ivezaj .........................................9
Rasti i Adrian Bacaj .......................................13
Raste të Asistencës Sociale .............................13
Emergjenca Kosovare ....................................14
Nëna Tereze- Ligjerata Nobel ....................... 15

**Kulturë** ..........................................................26

**Arsim** ............................................................33
Studentët Bursistë........................................ 34
Aktivitete në Fushën e Arsimit ......................36

**Politikë** ....................................................... 42

**Organizim** ....................................................48

**Korrespondencë** ............................................54
Leter nga Viktor Ivezaj ..................................54
Leter nga Vinko Nikprelaj .............................54
Leter nga Amir Gjokaj ...................................55
Leter nga Simon Gjokë Shkreli .......................55
Leter nga Gjokë Zef Gojçaj ............................56

***Indexi i reklamave.........................................73***

Fondi Humanitar "Malësia" rezervon të gjitha të drejtat mbi botimin e plotë apo të pjesërishëm të përmbajtjes së kësaj broshurë. Për çdo interesim eventual ju mund te kontaktoni organet përgjegjëse të Fondit Humanitar "Malësia".

Teksti (nëse nuk figuron emri i autorit), reklamat, editimi, dizajnimi është shkruar dhe realizuar nga **Marjan Berishaj**. Të dhënat e pranishme në këtë broshurë bazohen në dokumentacionin arkivor të Fondit Humanitar "Malësia". Korrespondenca e Fondit është zgjedhur, edituar dhe formatuar në përputhshmëri të natyrës dhe hapësirës për prezentim.

Stafi drejtues i broshurës:

**Leonard Berishaj, Marjan Berishaj, Kolë Cacaj, Gjon Dedvukaj, Shaqir Gjokaj, Zef Gjokaj, Lekë Gjolaj, Mustafë Hakramaj, Gjon Ivezaj, Gjergj Junçaj, Martin Junçaj, Nikollë Junçaj, Zef Lulgjuraj, Gjokë Nicaj, Halil Nikaj ,Vasel Ulaj, Kolë Vulaj**

Fondi Humanitar “Malësia” është organizatë jofitimprurëse, i klasifikuar në sekcionin 501 (c) 3 të Kodit të Brëndshëm Tatimor. Kontributet mund të deklarohen kundrejt rembursimit taksor si për individët dhe korporatat dhe kontributet nga organizatat private trajtohen si distribuime kualifikuese duku iu menjanuar taksës shtesë.

*Fondi Humanitar “Malësia”*
*261 East Gun Hill Road*
*Bronx, NY 10467*

*Tel: 1-718-519-1100*
*Fax: 1-718-881-1829*
*e-mail: fh@fondihumanitar.org*

"MALESIA"

**Kryesia e Fondit Humanitar "Malësia"**

*Kryetar*:
**Lekë Gjolaj**
*Nënkryetar*:
**Zef Gjokaj**
*Sekretar*:
**Kolë Cacaj**
*Arkëtar*:
**Leonard Berishaj**

*Anëtarë të kryesisë:*
**Marjan Berishaj**
**Gjon Dedvukaj**
**Shaqir Gjokaj**
**Mustafë Hakramaj**
**Gjon Ivezaj**
**Gjergj Junçaj**
**Martin Junçaj**
**Nikollë Junçaj**
**Zef Lulgjuraj**
**Gjokë Nicaj**
**Halil Nikaj**
**Vasel Ulaj**
**Kolë Vulaj**

## Mesazh i Presidentit z. **Lekë Gjolaj**

Fondi Humanitar "Malësia" me veprimtarinë e tij 10 vjeçare ka dhënë një shembull ndihme, asistence dhe shprese në fusha të ndryshme të jetës, duke filluar nga fusha humanitare, shëndetësore, sociale, arsimore, kulturore, duke u përpiqur vazhdimisht për një avancim dhe mbrojtje të drejtave tona kombëtare shqiptare në trojet tona etnike.

Sigurisht që nevoja dhe kërkesat tona kanë qenë më të mëdha në kohën që jemi themeluar, para plotë 10 viteve, kohën në të cilën populli ynë, posaçërisht një pjesë e të cilit jeton në viset e ish jugosllavisë, përjetonte një dhunë mizore nga pushtetëmbajtësit shekullor sllav. Ne në atë kohë me entuziazëm të madh i jemi përvesh këtij misioni të cilin e vazhdojmë edhe sot.

Populli ynë gjatë këtyre viteve ka arritur disa objektiva: arritja e lirisë së popullit të Kosovës, stabiliteti i shtetit Shqiptar, kristalizimi i aspiratave të popullit tonë në Maqedoni dhe në Mal të Zi etj.

Ne Anëtarët e Kryesisë së Fondit Humanitar "Malësia" gjatë këtyre viteve jemi munduar që të kanalizojmë fondet e grumbulluara në ndihmë të refugjatëve kosovar të shpërngulur me dhunë nga Kosova në Mal të Zi, jemi përpjekur të mbulojmë shpenzimet e disa intervenimeve mjekësore, duke përmirësuar jetën dhe duke u zgjatur atë individëve të caktuar, kemi vazhduar me asistencën financiare studentëve më të mirë dhe më të rrezikuar nga pikëpamja financiare për të vazhduar shkollimin dhe studimet, kemi ndihmuar familjet të cilat kanë përjetuar vështirësi ekonomike si edhe familje të cilat kanë humbur prindërit e tyre në fatkeqësi të ndryshme, kemi ndihumuar në riparimin e shumë shkollave dhe shtëpiave të kulturës, kemi organizuar dhe financuar disa manifestime kulturore në Malësi, si edhe jemi përpjekur që shqiptarët e Malit të Zi të kenë një zë të përbashkët para faktorit ndërkombëtar.

Dhe ne këtë nuk e kemi bërë të vetmuar, e kemi bërë dhe e realizojmë me ndihmën tuaj, me ndihmën e popullit tonë shqiptar i cili banon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Detroit dhe Nju Jork. Deshiroj të falenderojë përzemërsisht të gjithë ata të cilët gjatë këtyre viteve na kanë ndihmuar në realizimin e programeve tona. Suksesin tonë ne e konsiderojmë edhe suksesin e komunitetit tonë shqiptar e posaçërisht sukses të popullit tonë Malësor këtu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

## FALENDERIM

Fondi Humanitar "Malësia" falenderon çdo individ i cili në një mënyrë apo në një tjetër ka ndihmuar në realizimin e programeve tona.

Shfrytëzojmë rastin të falenderojmë bashkëpunëtorët tonë z. Gjergj N. Ivezaj, z. Tom P. Gjokaj, z. Zef Gj. Ivezaj, dok. Lukë Gjokaj, z. Nosh Gjolaj, z. Xhemal Nikaj, z. Gjon Dreshaj, z. Nikollë Berishaj, z. Dedë Dushaj, av. Kolë Camaj, z. Marash Dedvukaj, të cilët për vite me radhë ndihmuan në realizimin e programeve tona. Një falenderim të veçante i kushtohet znj. Tereza Camaj, mjeke-oftomologe, e cila vazhdon të shërbejë si lidhje direkte e Fondit Humanitar me doktorë eminentë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Falenderojmë mjekët dhe stafin mjekësor në realizimin e suksesshëm të intervenimeve të tyre.

Në mënyrë të veçante falenderojmë personalitet religjioze, dom Anton Kqirën, famullitarin e Kishës së Shën Palit, i cili çdo herë që i jemi drejtuar ka berë më shumë se është e mundur për Fondin Humanitar "Malësia", at Pjeter Popaj, famullitarin e kishës "Zoja e Shkodrës" në Nju Jork.

Falenderojmë të gjithë anëtarët e Kryesisë së Fondit Humanitar të cilët me sakrifica udhëheqën organizatën gjatë këtyre 10 viteve. Në mënyrë të veçantë dëshirojmë të falenderojmë Anëtarët e Kryesisë të cilët për shkaqe të ndryshme nuk gjenden në udhëheqje të Fondit, z. Tomë Camaj, ish kryetar i Fondit dhe një ndër themeluesit e Fondit Humanitar, z. Zef Kalaj, z. Palokë Vulaj, z. Avdi Nikaj, z. Zeqir Beqaj, z. Pashk Nikprelaj, z. Mark Nucullaj, z. Nua Palushaj, zj. Valentinë Curanaj (Gorvokaj).

Falenderojmë z. Leonard Kalaj në softverin e ofruar për realizimin e kësaj broshure.

Dhe me në fund, por jo më së paku falenderojmë të gjithë ata të cilët dhanë sygjerime gjatë fazës përgaditore, e në veçanti z. Gjon Gj. Ivezaj, të botimit të kësaj broshure.

Fondi Humanitar "Malësia" falenderon individët dhe sipërmarrësit prezent në këtë broshurë me reklamat e tyre.

Për të reklamuar në broshurën tonë ju mund të kontaktoni Fondin Humanitar "Malësia" në telefonat përkatës si edhe nëpërmes faqes sonë të internetit në *www.fondihumanitar.org*.

Ju nëpërmes reklamës suaj bëni afirmimin e çështjes suaj si edhe përkrahni aktivitetin tonë në fusha të ndryshme.

Broshura jonë do të shpërndahet në Nju Jork, Detroit, vende të tjera në Shtete të Bashkuara të Amerikës ku jetojnë një numer i theksuar shqiptarësh, si edhe në vendlindje, në Malësi. Broshurën mund ta lexoni edhe në rrjetin e internetit ne adresën e lartëshënuar.

Që tani ju mund të kontaktoni Fondin Humanitar "Malësia" në rezervimin e faqes suaj në broshurën tonë të ardhshme. Ju përherë do të jeni të mirëseardhur në faqet tona, duke u siguruar një paraqitje dinjitoze të veprimtarisë suaj.

Le të publikojmë së bashku aktivitetin tonë duke u vënë në shërbim të kombit dhe atdheut.

Tel: 718.519.1100



*"Unë ndihem shumë e emocjonuar kur babi im më tregon mbi punët e Fondit Humanitar, për ndihëm që u dha ai shumë njerzve si Leze Gojçaj, dhe për Viktor Ivezaj, të cilët me ndihmën e Fondit u shëruan, dhe për ndihmat drejtuar studentëve, dhe shumë e shumë gjëra të tjera.*

*Unë këtë vit dollarët që mblodha për ditëlindje do t'ia dhuroj Fondit në mënyrë që të ndihmojë ndonjë që ka më shumë nevojë"*

*Suzana Zef Gjokaj*

## Humanizëm

Ndër programet kryesore të Fondit Humanitar "Malësia" është aktiviteti humanitar në shërbim të individit dhe popullatës në rrezik të egzistencës. Që vitin e parë kur jemi themeluar, ne kemi organizuar sjelljen dhe shërimin e studentes malësore znj. Leze Gojçaj. Lezja vazhdon sot të këtë një shëndet të plotë dhe të lumtur, vetëm e vetëm duke iu falenderuar aktivitetit tonë dhe të gjithë atyre të cilët këtë gjë e bënë të mundur. Ky aktivitet i Fondit është pasqyruar në broshurën tonë të vitit 1998, ku mund të gjenden emrat e të gjithë atyre të cilët kanë kontribur në shërimin e personit të lartëpërmendur. Po ashtu emrat e këtyre personave mund të lexohen edhe ne rrjetin e internetit duke shkuar në *www.fondihumanitar.org.*

Duhet theksuar se në shërimin e znj. Gojçaj një ndihmesë të madhe mbartën institucionet dhe organizatat e Shtetit Amerikan të cilat merren me sigurimet shëndetësore, meqënëse në maujin prill të vitit 1995 pacientja arrin të rregullojë dokumentët e qëndrueshmërisë së përhershme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo ishte e një rëndësie të veçantë për Fondin Humanitar "Malësia" mbasi një pjesë e të hollave të cilat u mblodhën për këtë rast shërbyen për mbulimin e programeve të tjera të Fondit.

Vitet e fundit Fondit Humanitar "Malësia" i janë paraqitur edhe 4-5 raste të tjera për të cilat ndihma jonë është esenciale.

**Rasti i Viktor Ivezaj**

Z. Viktor Ivezaj, nje djalosh-tani 30 vjeçar, për vite me radhë ishte i lidhur në karrocën sanitare, duke mos qenë në gjendje të mbahet në këmbet e veta. Në janarin e vitit 2000, pacienti Viktor Ivezaj iu nënshtrua disa intervenimeve kirurgjikale në gjymtyrët e tij, intervenime të cilat u realizuan në Klinikën Ortopedike të qytetit gjerman Giessen nga ekipi mjekësor i udhëhequr nga Prof. Dr. med.H. Sturz. Intervenimet mjekësore prej afro 30.000 dollarësh duke mos parashikuar ndërlikueshmërinë e tyre ishin shumë të suksesshme për vet pacientin. Viktori më në fund mund të leviz i lirshëm në këmbet e veta. Ne dëshirojmë me këtë rast të falenderojmë të gjithë ata të cilët kanë bërë të mundur realizimin e këtyre intervenimeve, ekipin mjekësor, dhe të gjithë ata të cilët me kontributet e veta monetare arritën të realizojnë këtë vepër humane, emrat e të cilëve jepen sa më poshtë:



**Viktor Ivezaj** *(para operacionit)*

1. Nikollë Prëka Bardhecaj
2. Pjeter Prëkë Bardhecaj
3. Marash — Beqi
4. Anton — Berishaj
5. Fran Malotë Berishaj
6. Gjon T. Berishaj
7. Martin Gj. Berishaj
8. Nua Nikollë Berishaj
9. Pashk Martin Berishaj
10. Pjeter Gj. Berishaj
11. Pjeter N. Berishaj
12. Zef Tomë Berishaj
13. — — Berisha
14. Dedë Zef Bojaj
15. Dodë — Bojaj
16. Gjokë — Bojaj
17. Marash — Bojaj
18. Martin Prëkë Bojaj
19. Nosh Fran Bojaj
20. Aleks — Burgaj
21. Anton — Camaj

22. Gjelosh L. Camaj
23. Gjon — Camaj
24. Mark Gjon Camaj
25. Nua Gjon Camaj
26. Palokë Gjetja Camaj
27. Prënk V. Camaj
28. Tomë Gjon Camaj
29. Gjergj — Çuni
30. Zef — Çuni
31. Dedë — Deda
32. Mark Gjokë Dedaj
33. Vasel — Dedaj
34. Gjokë Kolë Dedivanaj
35. Nikollë — Dedivanaj
36. Zef Dodë Dedivanaj
37. Fran L. Dedvukaj
38. Nikollë Mark Dedvukaj
39. Nikollë Z. Dedvukaj
40. Zef Pjeter Dedvukaj
41. Nikollë Prëkë Delaj
42. Anton Gj. Doda
43. Lekë Lud Dreshaj
44. Bardh — Duhani
45. Simon — Duhani
46. Anton — Dukaj
47. Lekë Nosh Dukaj
48. Gjergj — Dushaj
49. Lucë Mark Dushaj
50. Zef — Dushaj
51. Emir Prëkë Elezaj
52. Prënk — Elezi
53. Gjovalin — Gegaj
54. Gjokë — Gojani
55. Albert Lucë Gojçaj
56. Anton — Gojçaj
57. Dedë — Gojçaj
58. Gjergj Tomë Gojçaj
59. Gjokë — Gojçaj
60. Gjon Lucë Gojçaj
61. Kolë Pjeter Gojçaj
62. Lekë Pjeter Gojçaj
63. Mark Gjergj Gojçaj
64. Nikë — Gojçaj
65. Nua — Gojçaj
66. Palokë — Gojçaj
67. Pjeter Mark Gojçaj
68. Pretash — Gojçaj
69. Tom Palokë Gojçaj
70. Zef Tomë Gojçaj
71. Zef — Gojçaj
72. Lush — Grabanica
73. Nikollë — Grimaj
74. Martin Vuksan Gjeka
75. Gjon — Gjekaj
76. Petrit — Gjekaj
77. Gjovalin — Gjelaj
78. Kolë Martin Gjelaj
79. Lekë — Gjelaj
80. Rrok — Gjelaj
81. Toni — Gjelaj
82. Prël — Gjeloshaj
83. Anton N. Gjokaj
84. Astrit — Gjokaj
85. Fran — Gjokaj
86. Gjokë Tomë Gjokaj
87. Ilir Mark Gjokaj
88. Lucë Gjeloshi Gjokaj
89. Luigj — Gjokaj
90. Malotë — Gjokaj
91. Nikollë F. Gjokaj
92. Pashk N. Gjokaj
93. Prelë — Gjokaj
94. Prenk — Gjokaj
95. Selim — Gjokaj
96. Sherif — Gjokaj
97. Tomë P. Gjokaj
98. Tomë — Gjokaj
99. Vatë Gj. Gjokaj
100. Vatë Martin Gjokaj
101. Vatë — Gjokaj
102. Nrekë — Gjolaj
103. Llesh Marash Gjolaj
104. Martin Bel Gjolaj
105. Pashk Mark Gjolaj
106. Tomë — Gjolaj
107. Vasel — Gjonaj
108. Gjon — Gjonlleshi
109. Dokë — Gjurashaj
110. Kolë Martin Gjurashaj
111. Lekë P. Gjurashaj
112. Pashk Kolë Gjurashaj
113. Luigj — Hoti
114. Nua Gjon Ivanaj
115. Pashk — Ivanaj
116. Prëtë — Ivanaj
117. Tone Marku Ivanaj
118. Dodë — Ivezaj
119. Gjelosh Rrok Ivezaj

120. Gjergj Nikë Ivezaj
121. Gjeto Pjeter Ivezaj
122. Gjokë M. Ivezaj
123. Kole Martin Ivezaj
124 Luigj Martin Ivezaj
125. Luigj Nikolla Ivezaj
126. Malot Shtjefën Ivezaj
127. Marash Pjeter Ivezaj
128. Mikel Nikollë Ivezaj
129. Nikollë Marash Ivezaj
130. Nikollë — Ivezaj
131. Pal — Ivezaj
132. Patrik Prëtash Ivezaj
133. Pashk — Ivezaj
134. Pjeter Fran Ivezaj
135. Prëkë Gjeto Ivezaj
136. Prëkë Shtjefën Ivezaj
137. Prënk — Ivezaj
138. Shtjefën Gjergj Ivezaj
139. Vatë Nikë Ivezaj
140. Zef — Ivezaj
141. Zekë — Ivezaj
142. — — Ivezaj
143. Ferdinand Junçaj
144. Fran Gj. Junçaj
145. Gjelosh L. Junçaj
146. Gjergj M. Junçaj
147. Lucë Gjeto Junçaj
148. Nikollë — Junçaj
149. Rrok Dokë Junçaj
150. Tomë Zef Junçaj
151. Ton — Junçaj
152. Tonin — Junçaj
153. Vasel Dodë Junçaj
154. Vasel — Junçaj
155. Vuksan — Junçaj
156. Gjekë — Jusufi
157. Sokol — Kaçaj
158. Anton Kalaj
159. Fran — Kalaj
160. Gjelosh Kolë Kalaj
161. Gjovalin — Kalaj
162. Nikollë Luku Kalaj
163. Pashk Gj. Kalaj
164. Pashk Gjergj Kalaj
165. Vasel Pjeter Kalaj
166. Kolë Miculi Kastrati
167. Gjokë — Koji
168. Dom Anton Kqira
169. Lush — Kravanica
170. Gjergj — Lajçi
171. Miran — Lekoçaj
172. Pashk Gjon Lleshi
173. Dodë Zef Lucaj
174. Gjokë Zef Lucaj
175. Leze — Lulaj
176. Lum — Lulaj
177. Nikë T. Lucaj
178. Prëkë Lekë Lucaj
179. Prënk — Lucaj
180. Shtjefën — Lucaj
181. Dodë Zef Lulgjuraj
182. Dedë — Lulgjuraj
183. Gjelosh Lucë Lulgjuraj
184. Gjelosh — Lulgjuraj
185. Gjokë Kola Lulgjuraj
186. Kolë Prëloc Lulgjuraj
187. Lekë Gjergj Lulgjuraj
188. Lucë D. Lulgjuraj
189. Luigj — Lulgjuraj
190. Martin Kola Lulgjuraj
191. Mark Nikollë Lulgjuraj
192. Nikollë Martin Lulgjuraj
193. Pjeter Nush Lulgjuraj
194. Prëlë — Lulgjuraj
195. Rrok Gj. Lulgjuraj
196. Simon — Lulgjuraj
197. Tom Gjon Lulgjuraj
198. Zef Nikollë Lulgjuraj
199. Gjergj — Lumaj
200. — Malaj
201. Kolë Hilë Margilaj
202. Nikollë Hila Margilaj
203. Ujk — Martini
204. Anton — Micakaj
205. Gjokë Kolë Micakaj
206. Pjeter — Micakaj
207. Linë — Mili
208. Fran — Mirdita
209. Keq — Mirdita
210. Petrit — Musolli
211. Tune — Musolli
212. Dodë — Nicaj
213. Kolë Lekë Nicaj
214. Marash Peri Nicaj
215. Vasel — Nicaj
216. Nosh — Nika
217. Dedë — Nikolla

218. Gjon Nikollë Nikollaj
219. Lekë — Nikollaj
220. Mark — Nikollaj
221. Nikollë — Nikollaj
222. Pjeter Gj. Nikollaj
223. Zef — Noci
224. Tom — Noka
225. Gjekë Marash Nucullaj
226. Marash — Nucullaj
227. Kolë — Oroshi
228. Pashk — Oroshi
229. Pal — Palaj
230. Pjeter N. Paluca
231. Dedë — Palushaj
232. Driton — Palushaj
233. Gjergj Dedë Palushaj
234. Lukë — Palushaj
235. Kolë — Pashku
236. Simon — Palushaj
237. Lekë Pashk Pecaj
238. Vuksan Gjeka Pepaj
239. Gjon M. Perkaj
240. Tomë — Përlaskaj
241. Agostin — Pjetri
242. Marash Kolë Pllumaj
243. Zef — Pllumaj
244. Sokol — Pllumi
245. Nikë — Popaj
246. Kriste — Prani
247. Nikollë — Qira
248. Ndua — Rakaj
249. Gjovalin — Selca
250. Fran — Shkreli
251. Gjergj Kolë Shkreli
252. Gjergj — Shkreli
253. Llesh — Shkreli
254. Nikolin — Shyti
255. Gjekë Gjoku Sinishtaj
256. Gjeto L. Sinishtaj
257. Gjon Dodë Sinishtaj
258. Gjon F. Sinishtaj
259. Lekë — Sinishtaj
260. Luigj Bac Sinishtaj
261. Malotë Bacë Sinishtaj
262. Marash — Sinishtaj
263. Nish Prëç Sinishtaj
264. Pashk Nikollë Sinishtaj
265. Shtjefën — Sinishtaj
266. Gjokë Nikollë Stanaj
267. Marash — Stanaj
268. Nikë Tomë Stanaj
269. Kolë — Stani
270. Mark — Thaçi
271. Fedrik — Toma
272. Ndrecë — Tomaj
273. Gjelosh Gjokë Ujkaj
274. Pashk F. Ujkaj
275. Martin — Uli
276. Marash — Ulaj
277. Pal — Ulaj
278. Zef Nikë Ulaj
279. Gjekë Mark Vaseli
280. Tomë — Vaseli
281. Nikollë — Veshtaj
282. Mark Gjon Vuçinaj
283. Mark — Vuçinaj
284. Pashk Nikolla Vuçinaj
285. Rrok — Vuçinaj
286. Zef Nosh Vuçinaj
287. Anton — Vulaj
288. Dedë Martin Vulaj
289. Dilë Deda Vulaj
290. Fran Lukë Vulaj
291. Gjergj Martin Vulaj
292. Gjergj Zef Vulaj
293. Gjokë D. Vulaj
294. Luigj — Vulaj
295. Mare K. Vulaj
296. Mria — Vulaj
297. Nikollë Gjergj Vulaj
298. Nikollë — Vulaj
299. Nosh — Vulaj
300. Pjeter Gjergj Vulaj
301. Pjeter Luca Vulaj
302. Sokol Zef Vuskaj
303. Nikollë — Zefi
304. Tonin — Zefi
305. Zef - Zeka
306 Florenc — —
307 Fredi — —
308. Lorenze — —
309. Mikel — —
310. Peri — —
311. Pa Emer —

**Një falenderim i veçantë i kushtohet Kishës së Shën Palit në krye me dom. Anton Kqirën.**


**Viktor Ivezaj** *(pas operac.)*

Lista e mësiperme është e bazuar në dokumentat dhe shënimet tona, ku me rastin e grumbullimit të donacioneve vullnetre, vullnetarisht është lënë emri i donatorit. Kemi pasur shumë raste që vet donatori nuk ka dashur të jap emrin e vet duke mbetur anonnim. Sidoqoftë, Fondi Humanitar "Malësia" i falenderon nga zemra të gjithë ata që në një mënyrë apo në një tjeter kanë kryer detyrën e tyre humane në ndihmë të afërmit tonë.

**Rasti i Adrian Bacaj**

Z. Adrian Bacaj është një djalosh tjetër, i cili nga Shkodra e Malësisë së madhe u soll në Nju Jork në shtator të vitit 2001 për shërimin e syrit. Aksioni me vlerë prej afër 15,000 dollarësh ishte pjesërisht i suksesshëm pasi ai vetem estetikisht pësoi ndryshime.

Fondi Humanitar "Malësia" ka siguruar një numer të konsideruar vizash për qellime mjekimi për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mund të përmendim këtu ardhjen e z. Husein B. Dukaj(2001), znj. Kristjana Luigj Junçaj (2000), z. Kolë Camaj (2000), pastaj tani në kohrat e fundit kemi në proçes dy raste, ajo e znj. Arta Volaj e cila vuan nga një sëmundje kronike të zemrës, dhe ate të z. Nua Gojçaj nga Hoti i Malësisë, i cili do të vijë të kurojë sytë.

**Raste të asistencës sociale**

Deri më tani Fondi Humanitar "Malësia" ka bërë ndarjen e ndihmave humanitare familjeve të rrezikuara ekonomikisht, apo atyre familjeve të cilat për shkaqe të fatëkeqësish kanë mbetur pa titullarët e familjeve të tyre, apo kane humbur anëtarë të familjes.

Në këtë kategori bëjnë pjesë grupi i 38 familjeve:

Familje dyanëtarësh (1994-1996):

1. Gjergj Pali Ujkaj nga Cemi i Trieshit
2. Nua Prekë Zefi Gjokaj nga Rudina banues ne Podgoricë
3. Lulë Prekë Gjoni Gjolaj nga Luhari, Kakarriq
4. Prelë Frani Nicaj, Rraxa e Rrasës, Hot
5. Pjeter Paku Gojçaj, Helmicë, Hot
6. Drane Tomë Gjokaj, Milesh, Grudë
7. Prelë Mati Gjokaj, Tuz
8. Mark Gjolja Micakaj, Tuz
9. Nikë Pretashi Lucaj, Kojë
10. Gjekë Gjolja Micakaj, Tuz
11. Gjergj Zef Gjeku Lulgjuraj, Cem
12. Mark Zef Gjeku Lulgjuraj, Cem
13. Drane Kolë Dedvukaj, Bardhaj

Familje peseanëtarësh (1994-1996):

1. Xhemal Meto Brahit Gjokaj, Milesh
2. Gjeto Dedë Kalaj, Kshevë
3. Elez Adem Caku, Dinoshë
4. Islam Cen Halil Gjokaj, Dinoshë
5. Lulë Fran Nikrprelaj, Bëkaj
6. Mri Nucullaj
7. Tomë Nikë Dedvukaj

Familje shtatëanëtarësh (1994-1996):

1. Fike Axhaj, Tuz
2. Gjergj Kilë Maci Gjurashaj, Dhapar
3. Marukë Dodë Prëkë Gashi, Kojë

4. Zef Lulash Smaka Nucullaj, Kojë
5. Gjergj Kolë Ujk Rroku, Cem i Trieshit

Familje nëntëanëtarësh (1994-1996)

1. Ramë Sadik Tahiri Lulanaj, Dinoshë
2. Gjelosh Lucë Gojçaj, Traboin

Persona të vetmuar (1994-1996):

1. Tole Smajl Lucaj, Stjepoh, Triesh
2. File Gjergj Dedë Lulashi, Rudinë, Triesh
3. Bashkëshortja e Lukë Nikës Sinishtaj, Passhkallë, Grudë
4. Dilë Qoka Gojçaj, Nabom, Hot
5. Drane Lucë Berishaj, Tuz
6. Syraja Lulanaj, Dinoshë
7. Trigë Gjelosh Ivezaj, Pikalë
8. Palinë Prëkë Marashaj, Kojë
9. Bashkëshorten e Gjelosh Kolës, Tërgajë
10. Tereze Kolë Gjonaj
11. Mare Kolë Gjolaj

Kohrat e fundit janë ndihumuar familjet e:

1. Nosh Gjekës Nucullaj (2003)
2. Rrok Lajçaj
3. Mark Palokë Junçaj

**Emergjenca Kosovare**

Me eskalimin e krizës në Kosovë, duke filluar nga fillimi i vitit 1998, kur Kosova ballafaqohej me një krizë të rëndë si pasojë e represionit të vazhduar serb, dhe si pasojë e drejtëprdrejtë e kësaj dhune, shumë familje kosovare shpëtimin e vetëm e gjetën në braktisjen e vatrave të veta shekullore, duke u shpërngulur në këtë mënyrë edhe në rajonin e Malësisë. Popullata vendase perveç halleve të veta ekonomike tani ballafaqohej edhe me hallet e vllezërve tanë të ardhur nga Kosova, me ç'rast në Malësi lindi nevoja për krijimin e një Këshilli Emergjent i cili do të merrej me menaxhimin e krizës së refugjatëve.
Fondi Humanitar "Malësia" nëpërmes kesaj shoqate humanitare ka bërë kanalizimin e kontributit me vlerë prej 11.000 dollarësh, për dy vite me radhë në ndihmë të refugjatëve. Refugjatët në këtë mënyrë kanë mundur më lehtë të gjejnë strehim dhe ushqim, si edhe prerja e biletave për kthim drejt vendlindjes.

Me fillimin e luftës së hapur në Kosovë, në muajin mars të vitit 1999, Fondi Humanitar "Malësia" në mënyrë të menjëhershme ka lëshuar 22,000 dollarë Fondit "Vendlindja Thërret". Më vonë Anëtarët e Kryesisë së Fondit kanë dal në publik ku gjatë dy javëve në kuadër të fushatës "Malësia për Kosovën" janë bashkuar 52 000 dollar të cilat i janë dorëzuar fondit të lartëpërmendur. Gjithashtu kontributi individual i Anëtarëve të Kryesisë së fondit nuk ishte i neglizhueshëm.

Fondi Humanitar "Malësia" është i hapur dhe i gatshëm të ndihmojë të gjithë ata të cilët i paraqiten pa dallim feje apo krahine, por gjithmonë duke u nisur nga mundësit reale financiare. Në një masë të madhe ndihmat tona varen nga kontributet vullnetare të popullatës shqiptare e cila jeton në Shtete të Bashkuara të Amerikës, dhe në veçanti nga popullata shqiptare e Detroitit.

*Një inspirim të vazhduar për aktivitetin tonë humanitar paraqet Nëna Tereze, Nëna Jonë e Madhe. Në faqet në vazhim ju mund të lexoni ligjeratën e saj dhënë me rastin e pranimit të Çmimit Nobel për Paqë.*

## **Nëna Tereze** - Shembull humanizmi sublim

Ligjerata Nobel më 11 dhjetor 1979

Pasi jemi bashkuar këtu së bashku për të falenderuar Zotin për çmimin Nobel të Paqes unë mendoj se do të ishte bukur që në të lutemi me lutjen e Shën Françeskut të Azizit e cila përherë më befason shumë-ne e recitojmë ketë lutje çdo ditë pas Kungimit të Shenjtë, sepse është shumë e përshtatshme për secilin nga ne, dhe gjithmonë befasohem që para 4-500 vjetëve kur Shën Françesku i Asisizit komponoi këtë lutje mbi problemet e njëjta që kemi tani, me te cilat ata atëherë ballafaqoheshin, duke kompozuar këtë lutje e cila përshtatet gjithashtu shumë bukur për ne sot.

*-Zot, bëju burim i paqes në mënyrë që, aty ku ndodhet urrejtja, unë mund të sjell dashuri;që atje ku ndodhet gabimi, unë të sjell shpirtin e faljes, që atje ku ndodhet mosmarrëveshja, unë mund të sjell harmoni; që atje ku ndodhet falsiteti, unë mund të sjell të vërtetën, që atje ku është dyshimi, unë mund të sjell besimin; që atje ku është dëshprimi, unë mund të sjell shpresë; që atje ku është errësira, unë mund të sjell dritë; që atje ku është pikëdhimi, unë mund të sjell gëzim.*

*Zot, dhuro ata që unë më shumë të shërbejë, sesa të shërbehem, të kuptojë sesa të kuptohem; të dua sesa të duhem; pasi duke harruar vehten njeriu gjen; të falish do të thot të falësh; është vdekja që njeriu zgjohet në jetën e amshuar.*

Mendoj se ndonjë nga ju e ka kuptuar-prandaj ne do të lutemi së bashku. Le të falenderojmë Zotin për mundësinë që ne të gjithë së bashku kemi sot, për këtë dhuratë të paqes e cila na përkujton se ne jemi të krijuar për të jetuar në paqë, dhe Jezusi u bë njeri për të sjellur lajmin e mirë te të varfërit.

Ai duke qenë Zot u bë njeri në të gjitha gjërat sikur ne përveç mëkatit, dhe ai proklamoi shumë qartas që ai ka ardhur të jap lajme të mira. Lajmi ishte paqja te të gjithë njerëzit vullnetmirë dhe kjo është diçka që të gjithë ne e duam – paqja në zemër - dhe Zoti e deshti botën aq shumë sa ai dha të birin e vetëm, dhe ai e dha ate te Maria Virgjër, dhe çfarë ajo bëri me të?

Ai sapo erdhi në jetën e saj- menjëherë pa u vonuar shkoi të jap lajmin e mirë, dhe duke shkuar në shtëpinë e kushririt të saj, foshnja – foshnja e palindur – foshnja në barkun e Elizabetës, kërceu nga gëzimi. Ai ishte djali i vogël i palindur, ishte lajmëtari i parë i paqes. Ai njohu Princin e Paqes, ai njohu që Krishti ka ardhur për të sjell lajmin e mirë për ju dhe për mua. Dhe sikur kjo mos të mjaftonte-nuk ishte mjaft që të bëhej njeri- ai vdiq në kryq duke treguar atë dashuri më të madhe, dhe ai vdiq për mua dhe për ty dhe për leprozin dhe për njeriun që është duke vdekur nga uria dhe për atë njeriun lakuriq që shtrihet në rrugët e jo vetëm të Kalkutës, por të Afrikës, dhe Nju Jorkut, Londrës dhe Oslos - dhe insistoi që ne të duam njëri tjetrin sikur ai don secilin prej nesh. Dhe ne e lexojmë atë shumë qartë në Ungjill – duaj si unë të desha ty – si të dua unë – si të deshti Ati, ashtu unë të dua-dhe sa më fort që Ati e deshti ate, ai na e dha ate, dhe se ne e duam njëri tjetrin, ne, po ashtu duhet të japim derisa të na dhemb. Nuk mjafton që ne vetëm të themi: "E dua Zotin, mirëpo nuk e dua fqinjin tim". Shën Gjoni thot se ju jeni mashtrues nëse thoni se ju doni Zotin dhe nuk doni të afërmin tënd. Si mund të duani Zotin të cilin nuk e shihni, nese ju nuk doni të afërmin tënd të cilin mund ta shihni, të cilin mund ta prekni, me të cilin ju

jetoni. Prandaj është shumë me rëndësi që ne të kuptojmë që dashuria, për të qenë e vërtetë, duhet që të dhemb. Dhe për të qenë të sigurtë që ne e mbajmë mend dashurinë e tij të madhe ai e bëri vehten bukë të jetës për të shuar urinë tonë për dashurinë e tij. Urinë tonë për Zotin, sepse ne u krijuam për atë dashuri. Ne u krijuam në imazhin e tij, ne u krijuam për të dashur dhe për tu dashur, dhe ai u bë njeri për të bërë të mundur që ne të duam sikur ai na deshi ne. Ai e bëri vehten të uritur – të zhveshur –të pashtëpi – të sëmurë- të burgosur – një të vetmuar – një të padëshiruar – dhe ai tha: "Ju ma bëtë mua". I uritur për dashurinë tonë, dhe kjo është uria e njerëzve tonë të varfër.
Kjo është uria që unë dhe ti duhet të gjejmë, e cila mund të jetë mu në shtëpinë tonë.

Unë nuk do të harrojë kurr një rast kur unë vizitova një shtëpi në të cilën ndodheshin prindërit e shumë djemëve dhe vajzave, të cilët i kishin vendos në institucion dhe ndoshta edhe harruar. Dhe une shkova atje, dhe unë pash në atë shtëpi që ata kishin gjithçka, gjëra të bukura, mirëpo secili shikonte nga dera. Dhe në asnjë prej tyre unë nuk pash një buzëqeshje në fytyrë. Dhe une iu ktheva Motrës duke e pyetur: "Si është e mundur? Si është e mundur që njerzit t'i kenë të gjitha këtu, pse ata atëherë të gjithë shikojnë derën, pse ata nuk jane duke qeshur?" Unë jam mësuar të shoh buzqeshjen në njerëzit tonë, bile edhe njerëzit që janë për vdekje qeshin, dhe ajo tha: "Kjo është gati çdo ditë, ata presin, ata shpresojnë që djali apo vajza e tyre do tu vijë në vizitë". Ata janë në dhimbje sepse janë të harruar, - dhe shiko – nga kjo vjen e gjithë dashuria. Ajo varfëri vjen drejt në shtëpinë tonë, bile edhe lënja pas dore për të dashur. Ndoshta brënda në familjet tona ne kemi ndokënd që ndihet i vetmuar, i cili ndjehet i sëmurë, i cili ndjehet i shqetësuar, dhe ato janë ditë të vështira për të gjithë. A jemi ne atje, a jemi ne atje që t'i pranojmë, a është nëna atje që të pranojë foshnjën?

Unë u befasova kur pash në Përendim aq shumë djem të ri dhe vajza të reja duke iu dhanë drogës, dhe u mundova që të gjej shkakun - pse është kështu si është, dhe përgjigjia ishte: Sepse askush në familje nuk është për t'i pranuar. Babai dhe nëna janë shumë të nxënë sa nuk kanë kohë fare. Prindërit e rinj janë në ndonjë institucion rehabilitimi dhe fëmija i jepet rrugës dhe implikohet në diçka. Ne jemi duke biseduar për paqen. Këto janë gjëra qe thyejnë paqen, mirëpo thyesin kryesor të paqes unë sot shoh abortin, sepse është luftë direkte, një vrasje direkte-vrasje direkte nga vet e ëma.Dhe ne lexojmë në shkrimin shenjtë, për të cilën gjë Zoti thot shumë qartë: "Edhe nëse nëna mund të harrojë fëmijën e vet- Unë nuk do t'ju harroj-unë ju kam gdhëndur në shuplakë të dorës. Dhe është kjo që mua më prek më shumë, fillimi i kësaj fjalie, edhe nëse nëna harron diçka të pamundur-edhe nëse ajo ju harron-Unë nuk do t'ju harroj. Dhe sot më kryesori do të thot-shkatërruesi më i madh i paqes sot është aborti. Dhe ne që jemi duke qëndruar këtu-prindërit tanë na kanë dasht. Ne nuk do të ishim këtu nëse prindërit tanë do të bënin ata neve. Femijet tanë, ne i duam, ne i dëshirojmë, mirëpo çfarë për miliona? Shumë njerëz janë shumë, shumë të shqetësuar me fëmijët në Indi, me fëmijët në Afrikë nga i cili një numer i konsiderushëm vdesin, ndoshta nga keqëushuqyerja, nga uria dhe kështu me radhë, mirëpo miliona po vdesin me paramendim nga vet vullneti i ëmës së tyre. Dhe kjo është shkatërruesi kryesor i paqes sot. Sepse nëse një nënë mund të vras fëmijën e vet - çfarë mbetet është

që unë të vras ty dhe ti mua-dhe asgjë tjeter në mes. Dhe këtë unë i kërkojë Indisë, këtë kërkesë unë bëjë kudo: Le ta kthejmë fëmijën mbrapa, dhe duke qënë se ky vit është viti i fëmijës: Çfarë kemi bërë ne për fëmijën? Në fillim të vitit unë ngrita zërin, unë fola gjithëandej dhe thash: "Le ta bëjmë këtë vit vitin e lindjes së secilit fëmijë, dhe të palindur, të dashur". Dhe sot është mbarimi i vitit, a thua me të vërtetë ne i kemi bërë fëmijët të dashur? Unë do ju jap diçka të llahatarshme. Ne jemi duke luftuar abortin me adapcion, ne kemi shpëtuar me mijëra jetë, ne kemi dërguar fjalë pranë çdo klinike, te spitalet, stacionet e policisë – ju lutem mos shkatërroni femijën, ne do ta marrim ate. Prandaj në çdo orë të ditës dhe të natës përherë është dikush, ne kemi një numer jo të vogël nënash të pamartuara – tu thuash atyre eja, ne do të kujdesemi për ju, ne do të marrim fëmijën nga ti, dhe ne do ta bëjmë atë fëmijë me shtëpi. Dhe ne kemi pas nje kërkesë në rritje nga familjet të cilat nuk kanë fëmijë, ky është bekimi i Zotit. Dhe gjithashtu, ne jemi duke bërë edhe një gjë tjeter e cila është po aq e bukur - ne jemi duke mësuar lypsat tanë, pacientët tanë lebroz, banuesit tonë të rrënojave, njerëzit tonë në rrugë, planifikimin natyror të familjes.

Dhe në Kalkutë vetëm për gjashtë vite – e gjithë kjo vetëm në Kalkutë – ne kemi pasur 61,273 fëmijë më pak nga familjet të cilat përndryshe do t’i kishin, mirëpo për shkak se ata praktikojnë këtë rrugë të abstenimit, të vetëkontrollit, nga dashuria e vetme për njëri tjetrin. Ne u mësojmë atyre matjen e temperaturës së trupit e cila është shumë e bukur, shumë e thjeshtë, dhe njerzit tonë të varfër ate e kuptojnë. Dhe ju e dini se çfarë ata më kanë thënë? Familja jonë është e shëndetshme, familja jonë është e bashkuar, dhe ne mund të kemi fëmijë kurdo që duam. Shumë qartë-njerëzit e rrugës, ata lypsarë-dhe unë mendoj që sikur njerëzit tonë të veprojnë në mënyrë të tillë sa shumë njerëz ju dhe të gjithë të tjerët të cilët mund të mësojnë mënyrat dhe mjetet pa shkatërruar jetën të cilën Zoti krijoi në ne.

Njerëzit e varfër janë njerëz të mëdhenjë. Ata mund të na mësojnë shumë gjëra të bukura. Një ditë njëri nga ta erdhi të më falenderonte dhe tha: "Ju njerëzit të cilët keni betuar pastërtinë, ju jeni më të mirët për të na mësuar planifikimin familjar. Sepse nuk është gjë më shumë sesa çeshtje e vetkontrollit nga dushuria për njëri tjetrin". Dhe unë mendoj se ata thanë një fjali të bukur. Dhe ata janë njerëz të cilët ndoshta nuk kanë çfarë të hanë, ndoshta nuk kanë as shtëpi ku të jetojnë, mirëpo ata janë njerëz të mëdhenjë. Njerëzit e varfër janë shumë njerëz të bukur. Një mbrëmje ne shkuam jashtë dhe ne morëm katër njerëz nga rruga. Dhe njëri nga ata ishte në gjendje shumë të rëndë – dhe unë u thashë Motrave: "Ju kujdesuni për ata tre tjerët, unë do të marr këtë që po duket më keq". Dhe unë bëra për të gjithë ate që dashuria ime mund ta bënte. E vendosa ate në shtrat, dhe aty pash një buzqeshje të bukur në fytyrën e saj. Ajo mori dorën time, sikur të thoshte një fjalë të vetme: "Ju falemnderit" – dhe ajo vdiq.

Unë nuk kisha si të ndihmoja vetëm të shqyrtoja koshencën time para saj, dhe unë pyeta vehten se çfarë do të thonja po të isha në vendin e saj. Dhe pergjigjia ime ishte shumë e thjeshtë. Unë do të përgjigjesha në mënyrën që të tërhiqja pak vemendjen në mua,unë do të thoshja se unë isha e uritur, që jam duke vdekur, që kam ftohtë, që jam në dhimbje, apo diçka tjetër, mirëpo ajo më dha diçka më shumë – ajo

më dha dashurinë e saj madhështore. Dhe ajo vdiq me buzëqeshje në fytyrën e saj. Si ai njeriu të cilin e nxorëm nga kanali i ujit, gjysëm i ngrënë nga krimbat, dhe ne e sollëm te shtëpia. "Unë kam jetuar sikur një kafshë nëpër rrugë, mirëpo tani do të vdes sikur një engjëll, i dashur dhe i përkujdesur". Dhe ishte shumë madhështore të shihje madhështinë e atij njeriu i cili mund të fliste ashtu, i cili mund të vdiste ashtu pa fajësuar njeri, duke mos sharë njeri, duke mos krahasuar asgjë. Sikur një engjëll- kjo është madhështia e njerëzve tonë. Dhe kjo është që ne besojmë se çfarë ka thënë Juzusi: "Unë isha i uritur – Unë isha i zhveshur- Unë isha pa shtëpi-Unë isha i padashur, i pakujdesun-dhe ti e bëre ate për mua".
Unë mendoj se ne nuk jemi punëtor social të vërtetë. Ne mund të bëjmë punë sociale në sy të popullit, mirëpo ne jemi vërtetë kontemplues në zemer të botës. Ne jemi ato që prekim Trupin e Krishtit 24 orë. Ne kemi 24 orë në dispozicion, kështu unë dhe ju. Ju gjithashtu mundoheni të sillni atë pranin e Zotit në familjet tuaja, sepse familja e cila lutet së bashku qëndron së bashku. Dhe unë mendoj se në familjet tona nuk na nevojiten bombat dhe armët, që t'i shkatërrojmë për të sjellur paqen - vetëm bashkohuni së bashku, duani njëri tjetrin, sillni atë paqe, atë gëzim, atë forcë të prezencës së çdonjërit prej nesh në shtëpi. Dhe ne do të jemi në gjendje të tejkalojmë të gjithë të keqen e cila ndodhet në botë.

Ka shumë vuajtje, shumë urrejtje, shumë mjerim, dhe ne me lutjet tona, me sakrificën tonë ia fillojmë nga vendi ynë. Dashuria fillon në shtëpinë tonë, dhe nuk është me rëndësi se sa ne punojmë, mirëpo sa dashuri ne vendosim në atë që ne bëjmë. Është te i madhi Zot –sa shumë ne bëjmë nuk ka rëndësi shumë, sepse ai është i pafund, mirëpo sa dashuri ne vendosim në atë veprim. Sa shumë ne veprojmë ndaj Tij në personin të cilin ne shërbejmë.

Kohë më pare në Kalkuta ne kishim vështirësi të mëdha ta furrnizohemi me sheqer, dhe unë nuk di se si fjala shkoi në vesh të fëmijëve, dhe një fëmijë i vogël katërvjeçar, një voglush Hindu, shkoi në shtëpi dhe u tha prindërve të vet: "Unë nuk do të ha sheqer për tri ditë, unë do t'ia jap sheqerin Nëna Terezes për fëmijët e saj". Pas tri ditësh babai dhe nëna e tij e sollën në shtëpinë tonë. Unë nuk i kisha takuar më parë ndonjëherë, dhe ky voglushi mezi që mund të theksonte emrin tim, mirëpo ai e dinte saktësisht se për çfarë ka ardhur. Ai e dinte se ai donte të ndante dashurinë e tij.

Dhe kjo është arsyeja pse unë marr kaq shumë dashuri nga ju të gjithë. Që nga koha e ardhjes sime këtu unë jam thjesht rrethuar nga dashuria, dhe me dashuri reale, dashuri të kuptueshme reale. Ndjen sikur çdonjëri në Indi, çdonjëri ne Afrikë është dikush, dikush shumë special për ty. Dhe unë po ndihem si në shtëpinë time gjë të cilën i thashë edhe Motrës sot. Unë ndjehem në kuvend me Motrat sikur të isha në Kalkutë me Motrat e mia. Aq tërësisht në shtëpi këtu, pikërisht këtu.

